



01/Nr. 975 /2025
Data : 11.02.2025

PROCESVERBALI I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

Nga mbledhja e parë -I- për vitin 2025 e Komitetit për Politik dhe financa, mbajtur me datë 22.01.2025 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: **Sevdi Dernjani** (Nënkryetar i Komunës), **Abduraman Bushi** (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Lindita Ballazhi** (Drejtoresh për Buxhet dhe Financa), **Natyra Kalisi** (Drejtoresh e Administratës), **Nexhmedin Daci** (Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoresh për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm), **Hisni Luri** (Drejtor për Arsim), **Vjosa Rogaçi** (Zyrtare për Barazi Gjinore), **Bashkim Sopa** (Zyrtarë për Transparencë).

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti financiar për vitin 2024.
3. Plani i punës së këshillave të fshatrave për vitin 2025.
4. Raporti i planit lokal të veprimit për barazi gjinore për vitin 2024.
5. Raporti i mekanizmit kundër dhunës në familje në Han të Elezit.
6. Raporti i ekipit komunal për të drejtat e fëmijëve në Han të Elezit.
7. Informatë mbi veprimtarit e subjekteve afariste për vitin 2024.
8. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Raporti financiar për vitin 2024.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson:- buxheti i komunës së Hanit të Elezit i ndarë sipas Ligjit me nr. 08/L-260 mbi ndarjet buxhetore të Republikës së Kosovës për vitin 2024 është në lartësi prej 3,349,278.00 €. Ky buxhet është ndarë sipas kategorive ekonomike si në vijim: Paga dhe shtesa 2,075,272.00 €, Mallra dhe shërbime 524,500.00 €, Shpenzimet komunale 93,500.00 €, Subvencione dhe transfero 113,000.00 €, Shpenzime kapitale 543,006.00 €, Totali i buxhetit 3,349,278.00 €. Ndërsa buxheti përfundimtar është 4,010,573.67 €, ku në këtë shumë përfshihen: 1. Mjetet e ndara nga Grantet Qeveritare në shumë prej 3,140,771.42 €, 2. Projektioni i Të Hyrave Vetanake në shumë prej 274,376.00 €, 3. Bartja e të hyrave vetanake të pa shpenzuara nga vitet paraprake në shumë prej 133,029.70 €, 4. Mjetet e mbetura nga Donacioni i Qeverisë Japoneze për projektin “Ndërtimi aneksit për këmbësor në urën e Seçishtës” në shumë prej 15,923.01 €, 5. Donacioni nga Unioni Evropian për projektin dy vjeçar “A smart system for Early Floods Detection and Waste Monitoring in the Lepenc River Basin” në shumë prej 446,359.86 €, 6. Mjete të mbetura nga Grante të cilat janë bartur vit pas viti në vlerë prej 113.68 €. Shpenzimi i kategorisë buxhetore Paga dhe Shtesa për vitin 2024 është në shumë prej 2,141,141.42 € apo 100 % nga buxheti i alokuar për këtë kategori buxhetore. Krahasuar me vitin 2023 shpenzimi për këtë kategori përgjatë vitit 2024 është më i lartë për 153,743.10 € apo 7.74 % më shumë. Shpenzimi i kategorisë buxhetore Mallra dhe Shërbime për vitin 2024 është në shumë prej 519,794.18 € apo 85.33% nga buxheti i alokuar dhe planifikuar për këtë kategori buxhetore. Krahasuar me vitin 2023 shpenzimi për këtë kategori përgjatë vitit 2024 është më i lartë për 47,146.87 € apo 9.98 % më shumë. Shpenzimi i kategorisë buxhetore Shpenzime komunale për vitin 2024 është në shumë prej 81,219.67 € apo 86.87% nga buxheti i planifikuar për këtë kategori buxhetore. Krahasuar me vitin 2023 shpenzimi për këtë kategori përgjatë vitit 2024 është më i ulët për 7,577.89 € apo 8.53 % më pak. Shpenzimi i kategorisë buxhetore Subvencione dhe Transfere për vitin 2024 është në shumë prej 370,958.48 € apo 99.51% nga buxheti i alokuar për këtë kategori buxhetore. Krahasuar me vitin 2023 shpenzimi për këtë kategori përgjatë vitit 2024 është më i lartë për 284,003.06 € Shpenzimi i kategorisë buxhetore Shpenzime Kapitale për vitin 2024 është në shumë 470,563.19 € apo 67.39% nga buxheti i alokuar dhe 59.27% nga buxheti i planifikuar për këtë kategori buxhetore. Krahasuar me vitin 2023 shpenzimi për këtë kategori përgjatë vitit 2024 është më i ulët për 347,520.46 € apo 42.48% më pak. Nisur nga vlerësimi i përgjithshëm del se niveli i shpenzimit të buxhetit për këtë periudhë janar - dhjetor 2024 është në shumë prej 3,583,676.94 €. Të hyrat janë paraqitur edhe direkte dhe indirekte dhe në materialin që e keni pranuar të hyrat nuk i kemi pasur për TM4, ndërsa në material të kuvendit do tua përcjellim edhe të hyrat e TM4 . Të hyrat direkte dhe indirekte janë në shumë prej 317,125.66 €. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

Sherif Berisha thekson:- sa i përket raportit të shpenzimeve afër 500 000 € janë pa shpenzuar nga mos dija apo nga keq menaxhimi i jua nuk keni ditur me i shpenzuar, ndërsa në anën tjetër jeni ankuar në Qeverinë e Kosovës. Te të hyrat vetanake të shërbimet publike, te ndërrim destinimi i tokës nuk paska fare të hyra e në anën tjetër në këtë Kuvend kemi miratuar shumë kërkesa të ndërrim destimit të tokës. Te pagesa e tatimit në pronë një diferencë prej 86 000 € më pak nga viti i kaluar. Te shërbimet e ndryshme kadastrale të hyrat prej 12 000 € për vitin 2023, ndërsa për vitin 2024 nuk pasa fare të hyra . Sa i përket investimeve kapitale shihet në raportin e juaj se sa keni shpenzuar dhe dihet që të gjitha projektet e mëdha në komunë tonë janë investime qeveritare.

Lindita Ballazhi thekson:- sa i përket suficitit që u potencua prej 500 000 € nuk qëndron kjo për shkak se një pjesë e tyre janë të hyra vetanake të cilat barten në vitin aktual 2025. Mjetet financiare prej donacioneve nga qeveria japoneze dhe nga unioni evropian do të barten në këtë vit. Te kodi ekonomik i të hyrave të ndërrim destinomi i tokës pasi që nuk kemi qenë të barazuar me divizionin e të hyrave dhe më herët potencova që materialin të cilin do ta pranoni për kuvend ka ndryshime të të hyrat. Te ndërrim destinomi i tokës inkasimi te ky kod ekonomik është 241.00 €. Sa i përket tatimit në pronë kemi një diferencë për shkak se ka të bëjë me faljen e tatimit në pronë.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU RAPORTI FINANCIARË PËR VITIN 2024 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

3. Plani i punës së këshillave të fshatrave për vitin 2025.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Natyra Kalisi thekson:- përveç materialit të cilin e kemi përcjell diçka të veçantë nuk kam për me shtuar.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU PLANI I PUNËS SË KËSHILLAVE TË FSHATRAVE PËR VITIN 2025 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

4. Raporti i planit lokal të veprimit për barazi gjinore për vitin 2024.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Vjosa Rogaçi thekson:- raportin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU RAPORTI I PLANIT LOKAL TË VEPRIMIT PËR BARAZI GJINORE PËR VITIN 2024 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

5. Raporti i mekanizmit kundër dhunës në familje në Han të Elezit.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU RAPORTI I MEKANIZMIT KUNDËR DHUNËS NË FAMILJE NË HAN TË ELEZIT QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

6. Raporti i ekipit komunal për të drejtat e fëmijëve në Han të Elezit.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU RAPORTI I EKIPIT KOMUNAL PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE NË HAN TË ELEZIT QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

7. Informatë mbi veprimtarit e subjekteve afariste për vitin 2024.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Majlinda Kaloshi thekson:- sipas statistikave që i kemi janë të regjistruara 35 biznese të reja. Sipas statistikave që Drejtoria ka, në Qendrën për Regjistrim të Qytetarëve që nga fillimet e saj e deri më tani janë të regjistruar 391 biznese, nga ku: 234 prej tyre i takojnë atyre Individuale (B.I), 156 biznese SHPK dhe 1 biznes SHA. Përveç materialit të cilin e kemi përcjell diçka të veçantë nuk kam.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU INFORMATA MBI VEPRIMTARIT E SUBJEKTEVE AFARISTE PËR VITIN 2024 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

8. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sherif Berisha thekson:- kërkoj që ti përcillet kryetarit kjo pyetje që ta liron nga detyra nënkryetarit e komunës dhe drejtoreshën e shëndetësisë për shkak se drejtoresha ka kohë që nuk i intereson sektori i shëndetësisë dhe ju e dini se ky sektorë sa i rëndësishëm është.

Sevdi Dernjani thekson:- pyetjen ja përcjellim Kryetarit por përgjigjja do të jetë që kur ti liron kryeministri Ministrat dhe zëvendësministrat edhe kryetari na liron neve por me gjithë atë në kuvend e merr përgjigjen prej Kryetarit.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e shpalli të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoj në ora 11:34.

Procesmbajtësi
Ayni Bushi



Kryesuesi i Kuvendit
Florim Shkreta

